



Albert Pruskuqy,  
Msiola Monopshi Iliey



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2068/4 Prot.

Vlorë më 25.09.2024

VENDIM

Nr. 38, datë 23.09.2024

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 17, DATË 11.04.2024 " PËR MIRATIMIN E  
FORMATIT TË ÇERTIFIKATËS SË STUDIMEVE TË FORMIMIT TË VAZHDUAR  
NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE" TË SENATIT AKADEMIK TË  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020, "Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose çertifikatës së lëshuar nga IAL-të dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin e diplomave ose çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar, referuar shkresës Nr. 1940, datë 16.09.2024, së Drejtorisë së Edukimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.09.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në Vendimin e Senatit Akademik Nr.17, datë 11.04.2024, si më poshtë:  
**Në formatin e çertifikatës bëhen ndryshimet e mëposhtme:**
  - a) **Ishte** – "Formim i vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike"  
**Bëhet** – të "Formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike"
  - b) **Ishte** – "4.5 muaj"  
**Bëhet** – "1 (një) semestër"
  - c) **Ishte** – "Nr.krediteve 35 ECTS"  
**Bëhet** – "Nr.i krediteve 35 ECTS, Niveli 7 i KSHK"
  - d) **Shtohet** – "Nr. i diplomës së studimeve të përfunduara më parë"
2. Bashkëlidhur këtij vendimi formati i ndryshuar i Çertifikatës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore, Drejtoria e Edukimit për Ciklin e I<sup>te</sup> dhe të II<sup>te</sup> të studimeve.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Asoc. **Denada Sota**

